

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,236,500(dy milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) leke pa t.v.sh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1 dhe 2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41,

pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4 Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nepermjet nje deklarate se te gjithë tonerat duhet të jenë original ose ekuivalent dhe të paktën një toner rezervë për cdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.

2.5 Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nepermjet nje deklarate, me shpenzimet e veta transportin e të gjitha pajisjeve nëpër destinacionet përkatëse.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për pajisjen që posedon (të perkthyer /të noterizuar).

Në Katalogun/broshurën/skedën teknike të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i pajisjes së ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve ose broshurave të paisjeve që posedon operatori ekonomik i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre. Në rast se paraqitja e tyre do kërkohej gjatë fazës së zbatimit të kontratës, dhe operatori ekonomik nuk do arrinte të sillte sipas specifikimeve teknike të kërkuara, autoriteti kontraktor do vihej në vështirësi pasi do detyrohej të hapte perseri garen nga e para, për një shërbim që është i perdritshëm dhe i domosdoshëm për autoritetin kontraktor.

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë minimalisht 2 punonjës të profilit IT të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Korrik 2025

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1 dhe 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kërkohej, citojmë: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) **aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe **aftësitë teknike e profesionale** për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë **zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm**

cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është minimal dhe lejon konkurrimin e hapur për të gjithë operatorët ekonomi të interesuar, duke marrë në konsideratë natyrën, kohëzgjatjen e shërbimit, shtrirjen e tij në territor

KUJDES

V111AAD=1.659.000

V111AAB=72.000

V328AAC=52.500

V424AAE=81.000

V823AAB=37.500

V822AAC=49.500

V912AAB=120.000

V043AAA=81.000

V626AAF=45.000

V091AAA=39.000

Operatorët ekonomik fitues duhet të ofertojnë brenda ketyre vlerave sipas preventivave perkates në të kundërt përbën kushtë për skualifikim

**OE PJESËMARRËS DUHET TË DORËZONJË NË SPE PREVENTIVIN E
PLOTËSUAR SIPAS KODEVE PËRKATËSE DHE FORMËS PËRKATËSE TË
NGARKUAR NGA AK DHE JO VETËM SASINË TOTALE TË ARTIKUJVE**

Argumentim. Për shkak të ndarjes buxhetore të këtyre kodeve Oe nuk mund të tejaklojnë fondin e parashikuar nga ana e AK pasi në të kundërt autoriteti nuk ka mundësinë financiare për ti shlyer detyrimin në rast të tejkalimit të fondit.

Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese , vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve

ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti: Realizimi shërbimit/printimit do të mundësojë kryerjen e printimit/ fotokopjimit/skanimit të dokumenteve të ndryshme shkresore të administratës, sipas përcaktimeve që janë bërë në hartimin e termave të referencës.

Shërbimi i printimit / fotokopjimit konsiston në ofrimin nga operatori e të gjitha pajisjeve, Letres A4/A3, pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes.

Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit. Për shkak të volumit të punës pajisjet duhet të funksionojnë pa asnjë ndërprerje dhe do të jenë të kompletuara me tonerë dhe pjesët konsumuese të tyre.

Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 24 orë nga marja dijeni për defektin e konstatuar. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 24 orëve pajisja duhet të zëvendësohet.

Shërbimi i printimit/fotokopjimit do të përfshijë:, për gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës mirëmbajtjen e pajisjeve në gjendje pune, furnizimin me tonerë, kryerjen e defekteve të ndryshëm në çdo kohë, zëvendësimin e pjesëve të konsumit (cilindra, zhvillues etj) sipas përcaktimeve që vijnë më poshtë.

Te gjitha pjeset e kembimit dhe tonerat do të përfshihen në cmimin për faqe. Shërbimet e transportit do mbulohen nga operatori ekonomik.

Institucioni Bashkisë Gjirokastrë, drejtorive në varësi të saj dhe 6 njesive administrative të saj kërkon të realizoj shërbimin e printimit dhe fotokopjimit. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi i kushteve normale të punës për punonjësit, nëpërmjet një shërbimi cilësor e të

vazhdueshëm, duke eliminuar problematikat e shumta të gatishmërisë së tyre të pajisjeve (tonerëve) që qarkullojnë në treg.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Institucioni Bashkisë Gjirokastrë, drejtorive në varësi të saj dhe 6 njësive administrative objektet ndodhur në këto adresa

Bashkia Gjirokastrë dhe drejtoritë në varësi, brenda qytetit Gjirokastrë

Njësia administrative Lunxhëri me adresë fshati Valare

Njësia administrative Odrie me adresë fshati Andon Poçi

Njësia administrative Lazarat me adresë fshati Lazarat

Njësia administrative Picar me adresë fshati Picar

Njësia administrative Antigone me adresë fshati Asim Zeneli

Njësia administrative Cepo me adresë Ura e Kardhiqit

Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër me shpenzimet e veta transportin e të gjitha pajisjeve nëpër destinacionet përkatëse.

Në cmimin e dhënë përfshihet dhe Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (37 pajisje A4/A3 bardhe zi/me ngjyra), të gjitha tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe çdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.

Nr	E VOGEL	Sasia	E MADHE	
	Aparati			
1	Bardh e zi A4	1		Protokollit
2	Bardh e zi A4	1		IMT
3	Bardh e zi A4	1		Pronat
4	Bardh e zi A4/A3	1		Prokurime
5		1	Bardh e zi A4/A3	Tatimeve
6	Bardh e zi A4	1		Burimet
7	Bardh e zi A4	1		Auditi
8	Bardh e zi A4 /A3	1		Kabineti
9	Ngjyra A4/A3	1		Nenkryetare
10	Ngjyra A4/A3	1		Sekretar I Pergjithshem
11		1	Ngjyra A4/A3	Urbanistika
12		1	Bardh e zi A4/A3	
13	Bardh e zi A4 /A3	1		Juridike
14	Bardh e zi A4 /A3	1		Financa 1
15		1	Ngjyra A4/A3	Financa 2
16	Ngjyra A4/A3	1		Gjendja civile
17	Bardh e zi A4	1		Sherbimi Social Arsimor

18	Bardh e zi A4	1		Policia
19	Bardh e zi A4	1		Performanca
20	Bardh e zi A4 /A3	1		Integrimi BE
	Njesite administrative			
21	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Lazarat
22	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Cepo
23	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Picar
24	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Antigone
25	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Odrie
26	Bardh e zi A4	1		Njes Admins Lunxheri
	Drejtore/ Agjencite			
27	Ngjyra A4/A3	1		Keshilli
28	Bardh e zi A4	1		Sherbimi social / Dhuna
29	Bardh e zi A4	1		
30	Bardh e zi A4	1		
31	Bardh e zi A4 /A3	1		Bujqesia
32	Ngjyra A4/A3	1		Emergjencat
33	Bardh e zi A4	1		Turizmi
34	Bardh e zi A4	1		Kultura
35	Bardh e zi A4	1		Komunale
36	Bardh e zi A4	1		Arsimi
37	Bardh e zi A4	1		Mzsh

Kjo është shpërndarja sipas zyrave të cilat kanë nevojën e pajisjes me fotokopje multifunksionale sipas rastit

Detyrat:

- Njësia e përcaktuar në fije do të thotë që në cmimin për njësi operatorët ekonomikë të llogarisin cmimin për një faqe printim / fotokopjim.

- **Autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë është I organizuar në zyra me hapësirë tepër të vogël prej 15 metër katror ku në të qëndrojnë tre tavolina pune apo 20 metër katror ku në të qëndrojnë 4 tavolina pune dhe hapësira e lirë për vendosjen e një printeri është tepër e vogël për këtë arsye ka qenë I detyrueshëm vendosja e dimensioneve si specifikim.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Per te realizuar sistemin e menaxhimit te sherbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kerkohen 37 (tridhjetë e shtatë) pajisje multifunksionale me specifikimet te pasqyruara ne specifikimet teknike:

- 22 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 bardh/zi – 35 faq/min
- 6 pajisje printer/fotokopje/skaner A4/A3 bardh/zi – 30 faq/min
- 5 pajisje printer/fotokopje/skaner A4/A3 color – 30 faq/min
- 2 pajisje printer/fotokopje/skaner A4/3 bardh/zi – 30 faq/min
- 2 pajisje printer/fotokopje/skaner A4/3 color – 30 faq/min

❖ **Specifikimet teknike per pajisjet dhe qe do te perdoren ne kete procedure.**

22 pajisje multifunksionale bardh e zi -A4 me keto specifikime

Funksioni	Fotokopje/Printer/Skaner
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia:	MIN 35 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	5 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , me e vogel se ose me e madhe se :	480x445x510
Kapacitetimbajtesisyrtaeve	Jo me evogel 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 250faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me ivogel	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB

Mundesit skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres) DADF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Kapaciteti SPDF/DADF	MIN 50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

6 pajisje multifunksionale bardh e zi– A4/A3 me keto specifikime teknike

<u>Fotokopje/Printer/Skaner</u>	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia:	MIN 30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	5 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , me e vogel se ose me e madhe se :	450*550*700
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo me e vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 250 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoje instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesit skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues

Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershëm të dy anëve të letres) DADF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD) skanimi me sd card të mundësohet dhe me adaptor
Kapaciteti SPDF/ DADF	MIN 30 faqe
Mobile printing(aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësojë encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimi në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësojë skanimin e dokumentave direct në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

5 pajisje multifunksionale me ngjyra -A4/ A3 me këto specifikime

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/color
Shpejtësia:	MIN 30 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	5 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , më e vogël se ose më e madhe se :	450*550*700
Kapaciteti mbajtës i syrtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letres	A6-A4
Memorja jo më i Vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësojë instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësojë skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues

Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres) DADF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Kapaciteti SPDF /DADF	MIN 30 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2 pajisje multifunkionale me ngjyra – A4/A3 me keto specifikime teknike

<u>Funksioni</u>	Fotokopje/Printer/Skaner
Teknologjia	Lazer/Color
Shpejtesia:	MIN 30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	5 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , me e vogel se ose me e madhe se :	590x690x1210
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo me e vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 250 faqe
Madhesia e letres	A4/A3
Memorja jo me i Vogel:	2 - 4GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoje instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues

Skanimi: ARDF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Kapaciteti ARDF	MIN 50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësojë encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja të mundësojë skanimin e dokumentave direct në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2 pajisje multifunksionale bardh e zi – A4/A3 me këto specifikime teknike

<u>Funksioni</u>	Fotokopje/Printer/Skaner
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia:	MIN 30 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	5 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H , më e vogël se ose më e madhe se :	590x690x1210
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo më e vogël 500 faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më e vogël 250 faqe
Madhësia e letres	A4/A3
Memorja jo më i vogël:	2 - 4GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësojë instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësojë skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues

Skanimi: ARDF	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Kapaciteti ARDF	MIN 50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Dimensioni E x D x H

Per arsye te hapesires se vogel te zyrove dhe vendosjes se tyre mbi tavolinat e punes AK ka vendosur nje maksimum te dimensioneve te pajisjeve te cilat do sillen nga OE. Duke qene se pajisjet office do vendosen mbi tavolina e punonjesve, hapesire e cila eshte kufizuar AK ka vendosur kufijte maksimal te pajisjeve, **por nuk pengon qe te pranojen pajisje me dimensione me te vogla.**

- Rezolucioni 1200 x 1200 dpi

Rezolucioni 1200 x 1200 dpi perkon me cilesine e printimit e cila tashme eshte bere standart per cdo pajisje e viteve te fundit.

- Kapaciteti mbajtes i syrtareve (jo me i vogel se)

Kapaciteti mbajtes i syrtareve eshte gjykuar sipas tipologjise se pajisjes eshte gjykuar qe te vendoset **jo me e vogel se , pra eshte vendosur nje minimum** por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet me te madh.

- Kapaciteti ne dalje i syrtareve (jo me i vogel se),

Edhe ky specifikim sipas tipologjise se pajisjes eshte vendosur **jo me e vogel se, pra eshte vendosur nje minimum por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet me te madh.**

- Memorja jo me e vogel 2 GB

Duke qene se pajisja perdoret nga disa operator njeheresh memorja e kerkuar duhet te ofroje procesim sa me te shpejte te dokumentave duke mos penguar operatoret e tjere qe jane ne pritje. Duke ditur si funksionon nje pajisje sa me madhe te jete kjo memorje aq me shpejt pajisja eshte funksionale per operatoret e tjere. Memorja e kerkuar ben te mundur qe pajisja te procesoje ne nje

kohe shume te shkurter nje material ne formate te ndryshme, gje e cila sjell mbarevajtjen ne proceset e puneve. Gjithashtu kjo memorje ben te mundur mosbllokimin e pajisjeve gjate printimeve me volum te larte MB. Nje memorje me e vogel rrit mundesine e bllokimit te pajisjes dhe automatikisht pengimin e proceve te punes.

- Hardisku jo me i vogel se 320

Hardisku jo me i vogel se 320 ben te mundur operimin e pajisjes nga disa operator njekohesisht, pavarsisht nga madhesia e dokumentit qe kerkohet te printohet. Gjithashtu ky harddisk ben te mund dhe volume te larta skanimi ne te njejten kohe. Ky hardisk lejon gjithashtu instalim e programeve te ndryshme ne pajisje. Me pak fjale ky hardisk nuk kufizon perdoruesin per perdorimin ne maksimum te pajisjes.

- Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)

Skanimi ne sisitemin spdf eshte sistemi i skanimit te njehershem te letres ne rastin kur ajo eshte e printuar duplex, pasi pajisja eshte e pajisur me dy skanere e cila e lexon letren njekohesisht. Ky lloj sistemi i skanimit lehteson jashtezakonisht shume skanimin e dokumentave , lehteson punen e perditshme, dhe kufizon problematikat e skanimit tek perdoruesit.

- Shpejtesia e skanimit jo me e vogel se:

Per kapacitetin mbajtes eshte gjykuar te jete **jo me i vogel se** sipas tipologjise se pajisjes, per arsye te madhesise se nje dokumenti per tu skanuar, por nuk pengohet qe te vije sillet me nje volum me te larte skanimi.

- Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.

Nje nga teknologjite e funksit per ruajtjen i dokumentave eshte cloud. Pajisja te mundesoje ruajtjen, printimin dhe skanimin e dokumentave te perdoruesve ne sistemet cloud.

Te gjitha keto opsione jane te domosdoshem pasi bejne te mundur perdorimin e pajisjes sa me te shpejte nga perdoruesi, e cila perkthehet ne kohe pune, sherbim cilesor dhe siguri ne transmetimin e te dhenave.

NJËSIA E PROKURIMIT

Laert Memisha

Bexhet Baxhella

Lorjana Shehu